



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 863 Prot.,

Tiranë, më 04/06/2021

LËNDA: Përcillen komentet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me “Raportin e Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë, për periudhën 2016 - 2020”.

DREJTUAR: **ZNJ. BRUNILDA DERVISHAJ**
PËRGJEGJËSE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Sektori i Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore
(Adresa: Rruga e Kavajës, Nr. 1001, Tiranë)

TIRANË

E Nderuar Znj. Dervishaj,

Në lidhje me kërkesën tuaj, të parashtruar në email-in e datës 07.05.2021, për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve në lidhje me Draft-Raportin e Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI, për periudhën 2016 – 2020, ju bëjmë me dije se:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, (i ndryshuar)¹, dhe në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarur publik:

- ✓ të attributeve që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ përbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”,

¹Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020 (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020).

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtroi në lidhje me “Raportin e Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë, për periudhën 2016 – 2020”, komentet si më poshtë:

Në Kreun IV, “Gjetjet nga zbatimi i PKV 2016 – 2020”, faqe 18 e Raportit, ku flitet mbi rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, për pikën e tretë të komenteve të tjera konstruktive të bëra, “*problemin e vazhdueshëm të gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese në media, sidomos në mediat online, si dhe për mungesën e reagimeve zyrtare ndaj gjuhës së urrejtjes*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson të theksojë se me Ligjin Nr. 124/2020 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, janë shtuar në nenin 3, forma të reja të diskriminimit, ndër të cilat është edhe “*gjuha e urrejtjes*”, si çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negative, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të LMD. Pra, nga ana e legjislacionit një problematikë e tillë, pritet në vazhdimësi që të ketë përmirësime. Përkufizimi theksojmë është bërë në përputhje me standartin e Këshillit të Europës.

Në po të njëjtën faqe të raportit, për pjesën e rekomandimeve të bëra nga ECRI, pika e dytë “*ECRI rekomandon që autoritetet (i) t’i japin Komisionerit për Mbrojtjen ndaj Diskriminimi kompetenca për të kërkuar nxjerrjen ose prodhimin e dokumenteve dhe informacioneve brenda një periudhe të caktuar kohe, (ii) të heqë detyrimin e organizatave që kanë një interes legjitim në luftën ndaj diskriminimit racia për të paraqitur një prokurë të veçantë dhe (iii) të rregullojnë çështjen e procedurave të njëkohshme para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe gjykatave*”, KMD bën të ditur se në lidhje me pikën e parë, me Ligjin Nr. 124/2020 “Për disa ndryshime në LMD”, në nenin 32/2 të LMD-së është parashikuar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.*” Ndërsa në nenin 33/7 është parashikuar afati, brenda të cilit subjektet që i është kërkuar informacion, duhet të kthejnë përgjigje: “*Me regjistrimin e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankesës dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve pune nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.*”

Në lidhje me pikën e dytë, me ndryshimet e reja të LMD-së, është evituar paraqitja e prokurës nga ana e organizatave, duke parashikuar që: “*Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave*”, (neni 33/2 i LMD). Ndërsa në gjykatë përfaqësimi rregullohet me prokurë ose deklaram para gjykatës, sipas parashikimeve edhe në K.Pr.Civile. (Shiko edhe nenin 34/3 të LMD).

Përsa i takon pikës së katërt të rekomandimeve të ECRIT, “*ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të përforcojnë reagimin e tyre jopenal ndaj gjuhës së urrejtjes, të mbështesin nismat e organeve të zgjedhura dhe nismat vetërregulluese të medias, të proçedojnë me shpejtësi në zgjedhjen e të gjithë anëtarëve të Autoritetit të Medias Audiovizuale*”, KMD sqaron se sikurse është cituar edhe më sipër, është futur për herë të parë termi i “gjuhës së urrejtjes”, dhe gjithashtu me ndryshimet e reja në nenin 33/17 është parashikuar se: “Operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt gjuhën e urrejtjes.”. Komisioneri informon gjithashtu që në dhjetor të vitit 2019 është krijuar Aleanca Kundër Gjuhës së Urrejtjes, e cila është një bashkëpunim midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit, Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Këshillit Shqiptar të Mediave, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe ndikimin në shoqëri si dhe monitorimin e saj, por edhe promovimin e modeleve pozitive sidomos të grupeve më të targetuara nga gjuha e urrejtjes dhe njëkohësisht më të pamundura në shoqëri.

Në lidhje me rekomandimet që jepen në Raport (faqe 19-20), pika e tretë, ku thuhet se: “*Të harmonizohet legjislacioni shqiptar në lidhje me të drejtat e njeriut të personave LGBTI me standardet e BE-së dhe të Këshillit të Evropës*”, KMD shton se në nenin 1 të LMD, me ndryshimet e Ligjit Nr. 124/2020, janë shtuar si shkaqe të mbrojtura edhe “karakteristikat e seksit” dhe “pamja e jashtme”.

Në pikën 5.1 “*Fusha e politikës. 1. Kuadri ligjor dhe institucional*”, (faqe 25 e Raportit), ku flitet për hapat pozitivë lidhur me ndryshimet ligjore të ligjeve të tilla Ligji “*Për ndihmën juridike*” dhe Ligji “*Për strehimin social*”, KMD rekomandon që në këtë paragraf të shtohet fakti që ndryshime ligjore ka pësuar edhe Ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, ndryshime të cilat kanë përmirësuar kuadrin ligjor lidhur me personat LGBTI.

Sa i përket “*Objektivit 1.2: Identifikimi i mangësive në legjislacion për garantimin e mosdiskriminimit dhe të drejtave të personave LGBTI*”, trajtuar në faqen 26 të Raportit, përsërisim si më sipër, se Ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, ka pësuar ndryshime në vitin 2020, në kuadrin e garantimit të të drejtave të personave LGBTI, qoftë në aspektin e futjes së shkaqeve të reja të mbrojtura, apo në format e diskriminimit. Në këto kushte, Komisioneri rekomandon që kur flitet për ndalimin e diskriminimit të personave LGBTI për shkak të orientimit social dhe identitetit gjinor, të shtohen si shkaqe të mbrojtura edhe “karakteristikat e seksit” dhe “pamja e jashtme”.

Në faqen 27 të Raportit, ku thuhet se “*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë përfshin në nenin 5 të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” ndalimin e diskriminimit në aktivitetet sportive për shkaqe si besimet politike ose fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, statusi ekonomik apo social*”, KMD shikon të arsyeshme të rekomandojë për të ardhmen që Ligji në fjalë, ndryshuar së fundmi me Ligjin Nr. 105/2020, të azhurnohet edhe me ndryshimet që janë bërë në LMD. Konkretisht, në nenin 5/3 të tij duhet të shtohen edhe “karakteristikat e seksit”, dhe “pamja e jashtme” si shkaqe të mbrojtura.

Në faqen 28 të Raportit, ku flitet mbi rekomandimet e bëra nga KMD për Kodin Penal, një pjesë e të cilave nuk janë marrë në konsideratë, dëshirojmë të sjellim në vëmendje që konkretisht rekomandimi për riformulimin e nenit 102 dhe shfuqizimin e nenit 102/a të Kodit Penal, në mënyrë që të eliminohej përdorimi i një gjuhe të papërshtatshme, me konotacion negativ dhe paragjykes, nuk është marrë parasysh.

Në raport përmendet se *“Megjithëse ende nuk është miratuar në Shqipëri një ligj i veçantë për Mbrojtjen e Personave Interseks, gjatë kohës së këtij Raporti Vlerësimi, me iniciativën e OJF Tirana Legal Aid Society”* (faqe 29), në lidhje me këtë, Komisioneri vlerëson se me ndryshimet e reja ligjore të LMD, garantohet e drejta e personave interseks për të mos u diskriminuar për shkak të “karakteristikave të tyre të seksit”. Kjo duhet konsideruar si masë pozitive e ndërmarrë.

Në faqen 31, ku thuhet se: *“Nëse trajnimi i nëpunësve civilë do të përfshihej në PKV - në e ardhshme, ASPA mund të bënte vlerësimin e nevojave për temat LGBTI dhe të angazhonte ekspertë, si për integrimin e çështjeve LGBTI në programin ekzistues, ashtu edhe për të hartuar module të dedikuara, siç ekzistojnë tashmë për barazinë gjinore”, Komisioneri rekomandon që në këtë aspekt të kishte një alternim midis ASPA-s dhe KMD-së, duke përcaktuar/hartuar së bashku modulet, apo duke angazhuar për këtë qëllim, punonjës të KMD-së, si trajnerë në fushën e diskriminimit.*

Në faqen 33, ku trajtohet përfshirja e madhe e OJQ-ve në mbrojtjen e të dhënave personale të personave LGBTI, Komisioneri dëshiron të sjellë në vëmendje se për të arritur një qëllim të tillë, u bënë ndërhyrje edhe në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në të cilin në nenin 33/4, është shfuqizuar gërma “a”, e cila parashikonte se ankesa nuk pranohet nëse është anonime. Ky ndryshim është bërë pikërisht për të motivuar rritjen e numrit të ankesave që lidhen me individë të komunitetit LGBTI por edhe të ankesave që lidhen me denoncimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës.

Ndërsa në pjesën ku jepen rekomandime (faqe 33), për ndryshime të mëtejshme ligjore apo përmirësime, veçanarisht në *“Kodin Penal (përdorimi i gjuhës diskriminuese ndaj personave LGBTI dhe nevoja për të përmirësuar përkufizimin e gjuhës së urrejtjes)”*, Komisioneri thekson që në rast iniciativash të tilla ligjore, në çdo rast përkufizimi i veprave penale që kanë të bëjnë me “gjuhën e urrejtjes” t’i përmbahet parashikimit të nenit 3/8 të LMD-së.

Në lidhje me *“Objektivi 2.3: Parandalimi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor nëpërmjet ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fuqizimit të OJF-ve për mbrojtjen e të drejtave LGBTI”*, faqe 38 e Raportit, theksohet se një nga rezultatet e pritshme ishte edhe *“iii. Rritja dhe zbatimi i sanksioneve”*. Sa i takon sanksioneve për rastet e diskriminimit për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor, apo karakteristikave të seksit dhe pamjes së jashtme, Komisioneri dëshiron të sjellë në vëmendje se LMD, parashikon në nenin 33/13 se: “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë: a) personi fizik, nga 10 000 deri në 60 000 lekë; b) personi juridik nga 60 000 deri në 600 000 lekë; c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri në 80 000 lekë; ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, nga 30 000 deri në 80 000 lekë.

d) personi fizik ose juridik, i cili kryen një ose më shumë nga format e rënda të diskriminimit, dyfishin e masës së gjobës së parashikuar përkatësisht në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 13, të nenit 33”. Me ndryshimet e bëra në vitin 2020, është shtuar gërma “d” e cituar më sipër.

Gjithashtu për ndërgjegjësimin e shoqërisë, është shtuar nenin 3/1, (Format e e rënda të diskriminimit), me përkufizimin se: “Çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit.” Një parashikim i tillë lindi si nevojë e praktikës së institucionit të KMD-së, por edhe faktit që një dispozitë e tillë, gjendet pothuajse në të gjitha ligjet e shteteve të rajonit. Si dhe është shtuar përkufizimi i “Diskriminimit strukturor”, si çdo formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njëjta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët.

Ndërsa sa i takon fuqizimit të OJF-vë për mbrojtjen e të drejtave të LGBTI, me ndryshimet e bëra në vitin 2020, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është shtuar që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe organizatat me interesa legjitime kanë të drejtë të paraqesin padi përpara gjykatës kompetente në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për çështje që lidhen me interesa kolektive, (neni 34/4 i LMD).

Në faqen 38, thuhet se KMD ka trajtuar ankesat lidhur me orientimin seksual dhe identitetin gjinor dhe ka filluar rishikimin e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Sikurse është cituar edhe më sipër, sqarojmë se ligji ka pësuar ndryshime, një pjesë e të cilave prekin edhe garantimin e të drejtave të personave LGBTI.

Në faqen 39 të Raportit, trajtohet rasti i një incidenti me gjuhë urrejtjeje nga një udhëheqës fetar, ku KMD bëri rekomandime për krerët e komuniteteve fetare dhe hyri në bisedime me këta udhëheqës. Në këtë paragraf thuhet se “Që atëherë, nuk janë raportuar incidente të gjuhës së urrejtjes nga figura fetare (KMD)”. Në lidhje me këtë, Komisioneri dëshiron të shtojë edhe një rast tjetër incidenti me gjuhë urrejtje kundër komunitetit LGBTI. Bëhet fjalë për rastin kur një personazh publik përdori gjuhën e urrejtjes në media dhe KMD pasi shqyrtoi rastin, vendosi diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, ndaj shtetasit P.B. Vendim-marrja e KMD u bë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nëpërmjet vendimit Nr. 4319 datë 18.12.2019, la në fuqi vendimin Nr. 108, datë 21.08.2019 të KMD-së. Subjekti kundër të cilit drejtohej vendimi i KMD-se, pranoi të kërkojë falje publike lidhur me fjalorin e tij diskriminues.

Duhet specifikuar gjithashtu se gjuha e urrejtjes kundrejt komunitetit LGBTI, në konstatimin e KMD-së, përdoret kryesisht nga subjekte politike dhe nga përfaqësues të lartë të këtyre subjekteve.

Nga leximi në tërësi i Draft-Raportit, rezultoi se në disa raste përdoret termi “*Komisioneri kundër Diskriminimit*” (faqe 48). Nga ana jonë rekomandohet që të ketë një unifikim të këtij termi në “*Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

Në faqen 70 të Raportit, flitet lidhur me koordinimin dhe monitorimin e një PKV-je të ardhshme. Në lidhje me këtë, Komisioneri nënvijëzon se problematika kryesore e komunitetit LGBTI është pikërisht diskriminimi i tyre. Në këtë kuadër, duhet të merret në konsideratë për PKV-në e ardhshme, roli monitorues i KMD-së, i cili shtrin kompetencat e tij si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,
Me konsideratë,

